Numër: 01-545 Datë: 30.07.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

V E N D I M

I. Akreditohet dhe Validohet, institucioni i aftësimit profesional, "United Pixels Academy". Rr. Afrim Loxha, nr.4/7 Prishtinë 10000 Kosovë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 25.07.2025 deri më 25.07.2028, me kualifikimin: **"Dizajn Grafik dhe Multimedia",** kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E). Numër total i kredive pesë (5), niveli V sipas KKK-së.

1. **"United Pixels Academy"**, mund të realizojë programin, **"Dizajn Grafik dhe Multimedia"** si vijon: numri i kandidatëve për një (1) grup mund të jetë maksimalisht dhjetë (10) kandidatë. Për një vit kalendarik mund të realizohen njëmbëdhjetë (11) grupe/cikle trajnimi, pra në total njëqind e dhjetë (110) kandidatë. Programi mësimor realizohet në 100 orë në total ku prej tyre janë 20 ore teorike profesionale, 67 orë praktike, 7 orë vetëstudim dhe 6 orë vlerësimi.

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së "United Pixels Academy" të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të institucionit për kualifikimin:**"Dizajn Grafik dhe Multimedia"** niveli V i KKK, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më 20.06.2025 për kualifikimin: **"Dizajn Grafik dhe Multimedia",** niveli V dhe vizitës së realizuar më 24.06.2025, pas përfundimit të procesit vlerësues, ka përpiluar raportet më 09.07.2025. Bazuar në analizën e dosjes së aplikimit dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitës, si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025. Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve mbështeten në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit, si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitave tek pala aplikuese.

AKK, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014, për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek KD i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "United Pixels Academy"
- Arkivit të AKK.